



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

<b>REFERENCË:</b>					
<b>Datë:</b>		15.04.2024			
<b>Për/Za/To:</b>		Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së			
<b>Përmes/Preko/Through:</b>		Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së			
<b>NGA/OD/FROM:</b>		Komisioni për hartimin e kriterëve: 1. Besim Murtezani, Kryesues 2. Ramë Hamzaj, Anëtar 3. Sibel Gutiq, Anëtar			
<b>Tema/Subjekat/Subject:</b>		Raport për përcaktimin e kriterëve për thirrjen publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok			
<b>Nr. i zyrës:</b>	11/17	<b>Lokacioni:</b>	Ndërtesa e ish "Rilindjes",	<b>Data:</b>	15.04.2024
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>		<b>Datum:</b>	
<b>Room No:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					X
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					X

I nderuar Ministër, z.Krasniqi,

Konform Vendimit të U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së, Nr.02-901/16, i datës 08.04.2024 për themelimin e Komisioni për hartimin e kriterëve për thirrjen publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, Komisioni ka bërë hartimin e kriterëve dhe paraqet për miratim.

Komisioni për hartimin e kriterëve për thirrjen publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, ka përcaktuar kriteret e përgjithshme, dhe dokumentacionin

e nevojshëm i cili duhet të dorëzohet për aplikim për subvencionim për ndërtimin e shtëpive.

Bashkangjitur gjeni kritereve e përcaktuara dhe dokumentet që duhet të dorëzohen nga aplikusit.

**Kriteret për mbështetjen në ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për të cilët ndihma është e nevojshme, si në vijim:**

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të posedoj dokument identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Të mos këtë shtëpi ose objekt banimi, (shtëpia ose objekti aktual i banimit të mos i plotësi kushtet për banim;
3. Dëshmi të posedimit të pronës për ndërtimin e shtëpisë në emër të aplikusit ose familjarëve të tij (*gjyshërit, prindërit, vëllezërve, motrave*);
4. Të mos ketë përfituar ndihmë për ndërtim të shtëpisë nga ana e Institucioneve shtetërore ose organizatave të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

**Dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet:**

1. Aplikacionin/Kërkesën e plotësuar më të gjitha të dhënat dhe të nënshkruar nga ana e aplikuesit;
2. Deklaratën nën betim që nuk ka përfituar më parë ndihmë për ndërtim/rindërtim/renovim të shtëpisë nga institucioneve shtetërore ose organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare;
3. Kopjen e Letërnjoftimit për aplikuesin;
4. Certifikate ose ekstrakt i lindjes për aplikusin;
5. Certifikatën e bashkësisë familjare;
6. Certifikatën e pronësisë ose dokument i noterizuar mbi disponueshmërinë e pronës, në emër të aplikuesit ose familjarëve si: *gjyshërit, prindërit, vëllezërve, motrave*.